



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07

**Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 23 qershor 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Urdhër për Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kalendarit të Rishikuar  
për Herë të Dytë të Pjesës së Mbetur të Procedurës Paraprake**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hysni Gucatit**

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bouden

**Mbrojtësit të Nasim Haradinajt**

Tobi Kadman

Karl Bakli

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në përputhje me nenet 39(1) dhe (13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 95(2)(a) dhe 96 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon urdhrin e mëposhtëm.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 11 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi pjesërisht aktakuzën e paraqitur nga Prokurori i Specializuar më 30 tetor 2020,<sup>2</sup> dhe urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) të paraqiste një aktakuzë të rishikuar, të konfirmuar (“Aktakuza”).<sup>3</sup>

2. Më 8 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim mbi mocionet paraprake të Mbrojtjes (“Vendim mbi Mocionet Paraprake”) duke konstatuar, ndërmjet të tjerave, se aktakuza paraqet me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme faktet mbi të cilat mbështeten akuzat dhe krimet, përfshirë format e përgjegjësisë për të cilat ngrihen akuzat.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetari, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-07, F00063, *Prokurori i Specializuar, Parashtrim i Aktakuzës për Konfirmim dhe i Kërkesave në lidhje me Të*, 30 tetor 2020, konfidenciale, me shtojcat 1 dhe 2, konfidenciale.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-07, F00074/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 11 dhjetor 2020, publik; F00075/A02, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë e Redaktuar*, 14 dhjetor 2020, publik.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-07, F00113/RED, Mbrojtja e z. Gucati, *Version i Redaktuar Publik i Mocionit Paraprak për Mangësi në Formën e Aktakuzës në përputhje me Rregullën 97(1)(b)*, 2 shkurt 2021 (mban datën e gabuar 30 janar 2021), publik; F00116/RED, Mbrojtja e z. Haradinaj, *Parashtrim i Ndryshuar me Redaktim Publike i Mocionit Paraprak mbi Problemin e Mangësive të Aktakuzës*, 31 mars 2021 publik; F00147, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet Paraprake*, 8 mars 2021, publik.

3. Më 8 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori një kalendar përmbledhës për pjesën e mbetur të procedurës paraprake, ku përcaktoi ndërmjet të tjerave, një afat për paraqitjen e Dosjeve Paraprake të Mbrojtjes dhe një datë paraprake për kalimin e dosjes gjyqësore (“Kalendari Përmbledhës”).<sup>5</sup>

4. Më 1 prill 2021, pas kërkesave të Mbrojtjes,<sup>6</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizoi pesë pika për apel të ndërmjetëm që buronin nga Vendimi mbi Mocionet Paraprake.<sup>7</sup>

5. Më 28 maj 2021, në konferencën e pestë mbi ecurinë e çështjes, Mbrojtja kërkoi zgjatje të afatit për paraqitjen e Dosjeve Paraprake deri më 12 korrik 2021.<sup>8</sup> Në të njëjtën kohë, palët bënë me dije se preferonin një konferencë shtesë për ecurinë e çështjes, pas paraqitjes së Dosjeve Paraprake të sipërpërmendura.<sup>9</sup>

6. Më 9 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori një urdhër për një kalendar të rishikuar, duke i kërkuar Mbrojtjes të paraqiste Dosjet Paraprake deri më 22 qershor 2021, duke caktuar datën e konferencës së gjashtë mbi ecurinë e çështjes më 25 qershor 2021 dhe duke caktuar një datë paraprake për kalimin e dosjes trupit gjykues të ardhshëm më 2 korrik 2021 (“Kalendari i Rishikuar për Herë të Parë”).<sup>10</sup>

---

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-07, F00148, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Kalendari Përmbledhës për Pjesën e Mbetur të Procedurës Paraprake*, 8 mars 2021, publik, para. 6(a)-(c).

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-07, F00151, Mbrojtja e z. Gucati, *Kërkesë për Leje për Apelimin e Vendimit KSC-BC-2020-07/F00147 në përputhje me nenin 45(2) dhe rregullën 77(1)*, 15 mars 2021, publik; F00153, Mbrojtja e z. Haradinaj, *Kërkesë për Leje për Apelimin e Vendimit KSC-BC-2020-07/F00147 në përputhje me nenin 45(2) dhe rregullën 77(1)*, 15 mars 2021, publik.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-07, F00169, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionet Paraprake të Mbrojtjes*, 1 prill 2021, publik.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-07, Transkript, 28 maj 2021, publik, f. 331, 336-337, 340.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-07, Transkript, 28 maj 2021, publik, f. 347-348.

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-07, F00224, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Kalendari i Rishikuar për Pjesën e Mbetur të Procedurës Paraprake dhe Urdhri për Caktimin e Datës për Mbajtjen e Konferencës së Gjashtë mbi Ecurinë e Çështjes (“Kalendari i Rishikuar për Herë të Parë”)*, 9 qershor 2021, publik.

7. Më 19 qershor 2021, Mbrojtja e Nasim Haradinajt kërkoi zgjatjen e afatit për paraqitjen e Dosjes Paraprake më 12 korrik 2021 (“Kërkesa për Zgjatje Afati”).<sup>11</sup> Më 21 qershor 2021, Mbrojtja e Hysni Gucati iu bashkua Kërkesës për Zgjatje Afati.<sup>12</sup> Më 21 qershor 2021 ZPS-ja u përgjigj se nuk kishte kundërshtim ndaj Kërkesës për Zgjatje Afati.<sup>13</sup>

8. Më 23 qershor 2021, Paneli i Gjykatës së Apelit dha vendimin e tij për apelin e Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionet Paraprake dhe urdhëroi panelin kompetent të udhëzojë ZPS-në që të paraqesë një version të korrigjuar të Aktakuzës sipas udhëzimeve të tij. (“Vendimi mbi Apelet e Mbrojtjes”).<sup>14</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Në përputhje me rregullën 95(2)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcakton një kalendar dhe një plan pune në lidhje me detyrimet e palëve gjatë procedurës paraprake.

10. Në përputhje me rregullën 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, sipas nevojës, mbledh një konferencë për ecurinë e çështjes me qëllim që: (i) të organizojë shkëmbime ndërmjet palëve për të garantuar përgatitje të shpejtë për gjykim; (ii) të ndërmarrë hapa për të garantuar kryerjen e të gjitha përgatitjeve të nevojshme nga palët në mënyrë të zellshme dhe në kohë; (iii) të rishikojë ecurinë e

---

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-07, F00241, Mbrojtja e z. Haradinaj, *Kërkesë e Mbrojtjes për të Ndryshuar Kalendarin e Përmbledhës* (“Kërkesa për Zgjatje Afati”), 19 qershor 2021, publik.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-07, F00242, Mbrojtja e z. Gucati, *Kërkesë e Mbrojtjes për të Ndryshuar Kalendarin e Përmbledhës*, 21 qershor 2021, publik.

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-07, F00243, Prokurori i Specializuar, *Përgjigja e Prokurorisë Ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për të Ndryshuar Kalendarin e Përmbledhës*, 21 qershor 2021, publik.

<sup>14</sup> KSC-BC-2020-07, IA004/F00007, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Mocioneve Paraprake*, (“Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes”), 23 qershor 2021, publik.

çështjes gjyqësore dhe t'u krijojë mundësi palëve që të ngrenë problemet që kanë lidhje me të.

### III. DISKUTIM

#### A. AFATI PËR PARAQITJEN E AKTAKUZËS SË KORRIGJUAR

11. Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh urdhrin e Panelit të Gjykatës së Apelit që urdhëron ZPS-në të dorëzojë një version të korrigjuar të Aktakuzës, sipas udhëzimeve të mëposhtme: (a) në përputhje me konstatimet e Panelit të Gjykatës së Apelit në Pikat 1-3, Aktakuza duhet të përmbajë detaje të mëtejshme për identitetin e bashkëkryerësve dhe bashkëpunëtorëve (minimalisht, si grup, kategori apo anëtarësi, dhe, kur është e mundur, me emër); (b) në përputhje me konstatimet e Panelit të Gjykatës së Apelit në Pikat 1-3, në paragrafët 41, 42, 43, 44, 45 dhe 46 të Aktakuzës duhet të përfshihen detaje të mëtejshme për personat e nxitur apo të ndihmuar; (c) formulimi “dhe/ose” në paragrafët 16, 26, 28, 30, 39 dhe 46 të Aktakuzës duhet të ndryshohet në përputhje me konstatimet e Panelit të Gjykatës së Apelit në Pikën 4; dhe (d) fraza “ndër të tjera” duhet të hiqet nga paragrafët 12, 21 dhe 27 të Aktakuzës dhe formulimi i këtyre paragrafëve duhet të rishikohet në përputhje me konstatimet e Panelit të Gjykatës së Apelit në Pikën 5.<sup>15</sup>

12. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se udhëzimet e Panelit të Gjykatës së Apelit në lidhje me versionin e korrigjuar të Aktakuzës kanë të bëjnë me: (i) shtimin e detajeve të mëtejshme të identitetit të bashkëkryerësve dhe bashkëpunëtorëve si dhe të kategorive të personave të nxitur dhe të ndihmuar; dhe (ii) ndryshimin dhe/ose heqjen e disa formulimeve, siç u shpjegua më lart. Duke pasur parasysh udhëzimet konkrete të dhëna nga Paneli i Gjykatës së Apelit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake

---

<sup>15</sup> Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes, para. 90.

konsideron se këto ndryshime duhet të zbatohen nga ZPS-ja në një periudhë relativisht të shkurtër kohore.

13. Në përputhje me sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në që të dorëzojë deri më 5 korrik 2021 një version të korrigjuar të Aktakuzës, sipas udhëzimeve të Vendimit mbi Apelet e Mbrojtjes.

#### B. AFATI PËR PARAQITJEN E DOSJEVE PARAPRAKE TË MBROJTJES

14. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se në Kalendarin e Rishikuar për Herë të Parë iu dha rëndësia e duhur procesit të nxjerrjes së provave që ka ndodhur që nga shpallja e Kalendarit Përmbledhës.<sup>16</sup> Për më tepër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mori parasysh nxjerrjet e provave në bazë të Vendimit F00210 dhe vendimeve të mëpasshme si dhe marrjen e çdo lloj materiali tjetër si pasojë e ndonjë kërkesë ende pa përgjigje nga një palë e tretë.<sup>17</sup> Duke mbajtur parasysh këto konsiderata por edhe duke vlerësuar ndikimin e pritshëm të nxjerrjeve të papërfunduara të provave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideroi të përshtatshme të zgjaste afatin për paraqitjen e Dosjeve Paraprake të Mbrojtjes deri më 22 qershor 2021.<sup>18</sup>

15. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Kërkesa për Zgjatje Afati përsërit në pjesën më të madhe parashtrimet e bëra nga Mbrojtja, të cilat Gjykatësi i Procedurës Paraprake i ka marrë parasysh gjatë shpalljes së Kalendarit të Parë të Rishikuar.<sup>19</sup> si pasojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, nuk do t'i shqyrtojë më tej këto argumente. I vetmi parashtrim i ri nga Mbrojtja ka të bëjë me kërkesën për leje për apelim të

---

<sup>16</sup> Kalendarin e Rishikuar për Herë të Parë, para. 19.

<sup>17</sup> Kalendarin e Rishikuar për Herë të Parë, para 19-20.

<sup>18</sup> Kalendarin e Rishikuar për Herë të Parë, para 19-22.

<sup>19</sup> Kërkesë për Zgjatje Afati, para 46-73. Mbrojtja e z. Haradinaj thotë shprehimisht se përsëriten parashtrimet e mëparshme, *shih* para 46, 65, 70.

miratuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake (“Apeli lidhur me Kërkesat B-C të Gucatit”).<sup>20</sup> Gjithsesi, Mbrojtja thjesht shprehet se nuk ka gjasa që një vendim mbi Apelin lidhur me Kërkesat B-C të Gucatit të merret para afatit për paraqitjen e Dosjeve Paraprake dhe nuk argumenton se përse dhe se si përfundimi i këtyre dosjeve mund të ndikohet nga një vendim apeli për këtë çështje.<sup>21</sup> Për këtë arsye Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk bindet se argumentet e parashtruara nga Mbrojtja për ligjin zgjatjen e afatit të 22 qershorit 2021.

16. Sidoqoftë, sipas Vendimit mbi Apelet e Mbrojtjes dhe urdhrit aktual që ZPS-ja të dorëzojë një version të korrigjuar të Aktakuzës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të arsyeshme t’i miratojë Mbrojtjes një zgjatje të mëtejshme afati për paraqitjen e Dosjeve Paraprake në mënyrë që ajo të shqyrtojë versionin e korrigjuar të Aktakuzës dhe të përshtasë atje ku është e nevojshme, argumentet e saj në dosje. Duke qenë se sipas udhëzimeve të Panelit të Gjykatës së Apelit, versioni i korrigjuar i Aktakuzës duhet të përmbajë detaje të mëtejshme dhe ndryshime dhe/ose heqje formulimesh për të siguruar më shumë konkretësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se këto ndryshime do të ndihmojnë Mbrojtjen në përgatitjen e dosjeve dhe nuk përbëjnë një pengesë apo vështirësi në përfundimin e tyre.

17. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të përshtatshme të zgjasë afatin e Mbrojtjes për paraqitjen e Dosjeve Paraprake deri më 12 korrik 2021.

---

<sup>20</sup> Kërkesa për Zgjatje Afati, para 74-76, referuar KSC-BC-2020-07, F00235, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Leje për Apelin të Vendimit mbi Kërkesat B-C të Gucatit*, 15 qershor 2021, konfidencial.

<sup>21</sup> Kërkesa për Zgjatje Afati, para 74-76.

### C. PARASHTRIME KONKRETE NË DOSJET PARAPRAKE TË MBROJTJES

18. Gjykatësi i Procedurës Paraprake i rikujton Mbrojtjes urdhrin e tij në Kalendarin e Rishikuar për Herë të Parë, për të përfshirë në Dosjet Paraprake të tyre çdo kundërshtim në lidhje me pranueshmërinë e provave, çdo marrëveshje të propozuar në lidhje me aspekte ligjore dhe faktike dhe çdo njoftim për arsyet që përjashtojnë përgjegjësi penale.<sup>22</sup>

### D. KONFERENCA MBI ECURINË E ÇËSHTJES

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton urdhrin e tij në Kalendarin e Rishikuar për Herë të Parë, që konferenca e gjashtë mbi ecurinë e çështjes të mbahej më 25 qershor 2021. Duke marrë parasysh Vendimin mbi Apelet e Mbrojtjes dhe afatet e rishikuara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shtyn konferencën e gjashtë të ecurisë së çështjes, të mërkurën më 14 korrik 2021, ora 15:00.

20. Në përputhje me rregullën 96(1) të Rregullores dhe duke marrë në konsideratë preferencën e shprehur nga palët për të mbajtur një konferencë mbi ecurinë e çështjes pas paraqitjes së Dosjeve Paraprake, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferencën e gjashtë të ecurisë së çështjes për të mbikëqyrur hapat përfundimtarë të kalimit të dosjes së çështjes. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u rikujton palëve se kalimi i dosjes së çështjes nuk do të thotë hapje e menjëhershme e çështjes sipas rregullës 124 të Rregullores dhe se hapa të mëtejshëm përgatitorë duhet të ndërmerren nga Trupi Gjykses, siç parashikohet në rregullat 116-119 të Rregullores.

---

<sup>22</sup> Kalendarin e Rishikuar për Herë të Parë, para 24-26.



21. Në konferencën mbi ecurinë e çështjes Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të kërkojë parashtrime me gojë në lidhje me pikat në vijim, sipas radhës së përcaktuar më poshtë:

- (1) Objekti i paraburgimit: një përditësim nga Administratorja mbi masat e marra për komunikimin mes mbrojtësve dhe klientëve të tyre;
- (2) Përkthimet: ndonjë shqetësim të mbetur të Mbrojtjes në lidhje me përkthimet e parashikuara me ligj;
- (3) Nxjerrja e provave: nëse palët po përballen ose parashikojnë vështirësi në lidhje me pjesën e mbetur të procesit të nxjerrjes së provave;
- (4) Kërkesat e Mbrojtjes: çdo kërkesë të papërfunduar të Mbrojtjes duke marrë parasysh versionin e korigjuar të Aktakuzës;
- (5) Hetimet e Mbrojtjes: nëse Mbrojtja është në gjendje për të dhënë përditësime për ecurinë e hetimeve të saj;
- (6) Kalimi i dosjes së çështjes dhe gatishmëria për gjyq:
  - a. Nëse palët parashikojnë ndonjë pengesë thelbësore për kalimin e dosjes së çështjes më 16 korrik 2021;
  - b. Kur mund të jetë ZPS-ja e gatshme për prezantimin e çështjes në gjyq; dhe
  - c. Kur mund të jetë Mbrojtja gati për prezantimin e çështjeve përkatëse, nëse do të jetë gati për ndonjërin prej tyre.

#### IV. VENDIM

22. Për arsyet e mësipërme Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë deri **të hënën, 5 korrik 2021** një version të korrigjuar të Aktakuzës, sipas udhëzimeve të Vendimit mbi Apelet e Mbrojtjes;
- b. **URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë deri **të hënën, 12 korrik 2021**, nëse dëshiron, Dosjet Paraprake, siç parashikohet në rregullën 95(5) të Rregullores;
- c. **URDHËRON** Mbrojtjen të përfshijnë në Dosjet Paraprake përkatëse çdo kundërshtim mbi pranueshmërinë e provave, çdo marrëveshje të propozuar në lidhje me aspekte ligjore dhe faktike dhe çdo njoftim për arsyet që përjashtojnë përgjegjësi penale, siç përcaktohet në paragrafët 24-26 të Kalendarit të Rishikuar për Herë të Parë;
- d. **ANULON** seancën e planifikuar për të premten, më 25 qershor 2021 në orën 11:00 dhe **VENDOS** të thërrasë një seancë në prani të ZPS-së dhe Mbrojtjes **të mërkurën, 14 korrik 2021, në orën 15:00;** dhe
- e. **CAKTON** si datë për kalimin e dosjes sipas rregullës 98(1) të Rregullores, **ditën e premte, 16 korrik 2021.**

\_\_\_\_\_  
/nënshkrimi/

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E mërkurë, 23 qershor 2021

Hagë, Holandë.